

Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen Rrjetet e Transferimit (2025–2028) nën Programin URBACT IV

Synimi i Thirrjes:

Synimi kryesor i thirrjes të mbështesë Bashkitë e Evropës që të ndërmarrin dhe përshtatin në kontekstin e tyre vendor një nga 116 Praktikat e Mira të URBACT (Good Practices), përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, përmirësimit të politikave lokale dhe ngritjes së kapaciteteve.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Fushat e veprimit janë të gjera dhe varen nga temat e praktikave të mira të përzgjedhura, por mund të përfshijnë:

- Politikat sociale dhe gjithëpërfshirjen;
- Digjitalizimin dhe inovacionin në shërbime publike;
- Tranzicionin e gjelbër dhe veprimin për klimën;
- Ekonominë vendore dhe punësimin;
- Politikat për rininë, kulturën dhe trashëgiminë;
- Qeverisjen e mirë dhe pjesëmarrjen qytetare.

Temat ndër-sektoriale që duhet të konsiderohen nga të gjithë:

- Tranzicioni digjital;
- Barazia gjinore dhe përfshirja sociale;
- Tranzicioni i gjelbër.

Rezultatet e pritshme:

- Njohje e thelluar dhe transferim i suksesshëm i një praktike të mirë në një kontekst të ri vendor.
- Hartimi i Planeve të Transferimit (Transfer Plans) nga çdo bashki partnere dhe një Plan Përmirësimi (Improvement Plan) nga bashkia udhëheqëse.
- Forcimi i kapaciteteve të administratave vendore në hartimin e politikave gjithëpërfshirëse.
- Rritja e pjesëmarrjes së aktorëve lokalë përmes URBACT Local Groups (ULG).
- Rritja e njohjes dhe vizibilitetit në nivel evropian.
- Ngritje kapacitetesh për zbatimin e politikave urbane të integruara
- Testimi i zgjidhjeve në terren (pilotime)
- Promovimi i rezultateve në nivel kombëtar dhe evropian

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në këtë thirrje mund të aplikojnë vetëm qytetet (autoritetet vendore) nga:

- BE (27 vendet anëtare);
- Norvegjia dhe Zvicra;
- Vendet IPA (Shqipëria, Bosnje & Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia);
- Ukraina dhe Moldavia.

Konsorciumi duhet të përbëhet nga:

- **1 Lead Partner:** Bashkia/Qyteti që zotëron Praktikën e Mirë të përzgjedhur
- 5–7 bashki partnere: Qytete që kërkojnë të transferojnë praktikën e mirë në bashkitë e tyre
- Numër total i partnerëve: 6–8 bashki

Konsorciumi duhet të jetë gjeografikisht i balancuar dhe nuk lejohet më shumë se një bashki për shtet.

Aktivitetet e Pranueshme:

- Takime ndërkombëtare (mininumi 6 fizike, + online),
- Vizita të ekspertit dhe partnerit drejtues në bashkitë partnere,
- Krijimi dhe funksionimi i Grupit Lokal URBACT (ULG),
- Aktivitetet lokale për përshtatjen e praktikës,
- Trajnime dhe kapacitete për politikë-bërje të integruar,
- Aktivitetet e komunikimit, përhapjes dhe raportimit

Nuk mbështeten investime infrastrukturore apo ndërhyrje të forta – vetëm aktivitete "soft".

Etapat e Rrjetit të Transferimit (STAGES):

Etapa	Kohëzgjatja	Qëllimi Kryesor
1. Njohje	Nëntor 2025 – Gusht 2026	Njohja e thelluar e Praktikës së Mirë, analizimi i transferueshmërisë dhe ndërtimi i partneritetit
2. Përshtatje	Shtator 2026 – Gusht 2027	Përshtatja e praktikës në kontekstin lokal, testimi i zgjidhjeve dhe draftimi i planeve
3. Ri-përdorim	Shtator 2027 – Prill 2028	Finalizimi i Planeve të Transferimit, vlerësimi, përhapja dhe mbyllja e rrjetit

Në secilën etapë përfshihen:

- Takime transnacionale
- Artikuj, raporte, ditarë rrjeti
- Trajnime dhe mentorim nga ekspertë të URBACT
- Aktivitetet e komunikimit dhe diseminimit

Cili është buxheti i thirrjes Buxheti dhe Bashkëfinancimi për Rrjetet e Transferimit:

Buxheti total i pranueshëm për një Rrjet Transferimi

Maksimumi i lejuar për rrjetin: **750.000 euro**:

- Kjo përfshin të gjitha fondet (ERDF, IPA, NDICI dhe bashkëfinancimin lokal/nacional).
- Ky buxhet mbulon 30 muaj zbatim dhe ndahen sipas pesë kategorive:

Kategoritë buxhetore

- **Staff Costs** – Paga dhe kontributet për stafin e projektit
- **Office & Administration** – Qira, shpenzime administrative
- **Travel & Accommodation** – Udhëtim dhe akomodim për aktivitete
- **External Expertise & Services** – Shërbime të jashtme, konsulencë, ekspertizë
- **Equipment** – Pajisje të nevojshme për zbatimin (me kufizime)

Normat e bashkëfinancimit sipas statusit të vendit:

Kategoria e Partnerit	Fondi që përdoret	Shkalla e financimit
Rajone më të zhvilluara të BE-së	ERDF	deri në 65%
Rajone në tranzicion të BE-së	ERDF	deri në 70%
Rajone më pak të zhvilluara të BE-së	ERDF	deri në 80%
Shqipëri, Ballkani Perëndimor (IPA)	IPA III	deri në 95%
Ukrainë & Moldavi (NDICI)	NDICI	deri në 95%
Norvegji, Zvicër	Fondet kombëtare	deri në 50%
Të tjerë (jashtë Programit)	Vetë-financim	100%

Për Shqipërinë: Bashkitë shqiptare financohen deri në 95% nga fondet IPA, dhe duhet të sigurojnë vetëm 5% bashkëfinancim lokal.

Buxheti total i pranueshëm për Ekspertizën

Maksimumi i lejuar për ekspertizën: **120.000 euro**

Nuk zbatohet norma e bashkëfinancimit – mbulohet plotësisht nga URBACT dhe përdoret për:

- Lead Expert (maks. 130 ditë / 750 EUR/ditë)

- Ad-hoc Experts (min. 30 ditë në total)
- Totali i ditëve të ekspertëve: maksimumi 160 ditë për rrjetin
- Shpenzimet për udhëtim dhe akomodim të ekspertëve mbulohen direkt nga Programi URBACT.

Si bëhet aplikimi:

- Duhet të gjendet një Praktikë e Mirë URBACT dhe të lidheni me bashkinë që e ka ideuar (Lead Partner)
- Ndërtohet konsorciumi (bashkitë e interesuara për transferim)
- Plotësohet aplikimi në Synergie-CTE platform (<https://urbact.eu/get-involved>)

Dorëzohen:

- Formulari i aplikimit
- Një letër angazhimi nga çdo partner
- Dokumente mbi përmbajtjen, metodologjinë dhe buxhetin

Kur është afati i fundit:

Aplikimet duhet të dorëzohen në sistem deri më 30 qershor 2025, ora 15:00 CET. Paketa me dokumente (PDF + letër angazhimi + CV) duhet të dorëzohet edhe me e-mail deri më datë 1 korrik 2025, ora 15:00 CET.

Datat e rëndësishme:

Webinare informuese të URBACT IV për aplikantët:

- 23 prill 2025 (10:00–11:30 CET) – Prezantimi i thirrjes dhe krijimi i një partneriteti
- 22 maj 2025 (10:00–11:00 CET) – Shkëmbimi i njohurisë dhe të nxënës gjatë rrjetizimit
- 17 qershor 2025 (10:00–11:00 CET) – Informacione teknike mbi aplikimin online
- 24 qershor 2025 (10:00–11:00 CET) – Kontroll teknik të aplikimit online përpara afatit

Aprovimi i projekteve:

- Vlerësimi nga Komiteti Monitorues i URBACT në tetor 2025
- Fillimi zyrtar i zbatimit: 1 nëntor 2025
- Përzgjedhja e Ekspertëve (Lead Experts)
- Njoftim i rrjeteve të aprovuara: tetor 2025
- Intervistat me URBACT dhe Partnerët Lead për ekspertët: tetor – nëntor 2025
- Takimi i parë i rrjeteve të aprovuara më 3–4 dhjetor 2025: Takimi zyrtar i lançimit për Partnerët Lead dhe ekspertët

Linku i Thirrjes:

<https://urbact.eu/get-involved>